

RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT PWR RREGULLOREN (AAC)
NR. XX/2025 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (AAC) NR. 17/2017
NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E SINJALEVE NË RAST TË DËSHTIMIT TË KOMUNIKIMIT
NË RADIO

21 nëntor 2025

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ të AAC-së Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren, si në vijim:

- Rregullore (AAC) Nr. XX/2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 17/2017 në lidhje me përdorimin e sinjaleve në rast të dështimit të komunikimit në radio

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, nga data 04 deri 19 nëntor 2025.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes për konsultim publik të palëve të interesit i është përgjigjur një palë e interesit me sugjerime dhe vërejtje, nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së:

Neni 2, Plotësimet dhe ndryshimet në Shtojcën IV të Rregullores (AAC) Nr. 17/2017

(c) “...Largohuni nga zona e uljes ose pista e taksive dhe kini kujdes nga avionët...”

Komenti 1, Burim Begu, LKIA: *Logjke dhe e kuptueshme, me mire do te kishte me qene PISTA se sa zona e uljes. Zone e uljes eshte vetem nje pjese e pistes, ku mund te largohesh nga ajo zone, dhe prape te jesh ne piste.*

Sqarim: *Ne moment qe hyn ne piste, pista llogaritet e tersishme me prezence trafiku, vetem m'varet ne cilen piste je (shtrirja magnetike).*

Përgjigja nga AAC: Komenti nuk pranohet. Termi “zona e uljes” (ang. *landing area*) është përdorur qëllimisht, sepse ka një kuptim më të gjerë se sa “pista” (ang. *runway*). Sipas definicionit nga CS ADR-DSN.A.002 të Rregullores (AAC) nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet, “*landing area*” i referohet çdo sipërfaqeje të përshtatshme për ulje ose ngritje të aeroplanëve, përfshirë pistat, por jo të kufizuar vetëm në to. Prandaj, zëvendësimi i këtij termi me “pista” do ta ngushtonte gabimisht fushën e zbatimit.

Komenti 2, Burim Begu, LKIA: *“Nuk kemi piste te taksive,”*

Përgjigja nga AAC: Komenti pranohet. Termi “pista e taksive” zëvendësohet me termin “rruga lidhëse (ang. *taxiway*)”, në përputhje me Shtojcën I të Rregullores (AAC) nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet.

Neni 2, Plotësimet dhe ndryshimet në Shtojcën IV të Rregullores (AAC) Nr. 17/2017

“...Largohuni nga zona e manovrimit në përputhje me udhëzimet lokale...”

Komenti 3, Burim Begu, LKIA: *Hapesira Manevruese eshte term qe ne perdorim per maneuvering area, nga kulla, vozitesit.*

Përgjigja nga AAC: Komenti nuk pranohet. Termi “zona e manovrimit” është e përkufizuar në Shtojcën I të Rregullores (AAC) nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet.

Neni 2, Plotësimet dhe ndryshimet në Shtojcën IV të Rregullores (AAC) Nr. 17/2017

(d) “...Në kushte emergjente , ose në rast se sinjalet e përcaktuara në pikën (c) nuk respektohen, përdoret sinjali i mëposhtëm për pistat ose rrugët e taksisë të pajisura me sistem ndriçimi, me kuptimin si më poshtë...”

Komenti 4, Burim Begu, LKIA: *Cilat jane kushtet emergjente? Kriteri?*

Përgjigja nga AAC: Termi “kushte emergjente (*ang. emergency conditions*)” përdoret qëllimisht pa listë kriteresh, sepse i referohet çdo situatë që kërkon reagim të menjëhershëm për shkak të rrezikut, si dështime të komunikimit, incidente në pistë apo çdo gjendje tjetër emergjente. Përcaktimi i një përkufizimi shtesë do ta kufizonte gabimisht kuptimin operacional të termit.

Komenti 5, Burim Begu, LKIA: *Kjo eshte nese nuk verehen (observed), jo respektohen.*

Përgjigja nga AAC: Komenti pranohet. Termi “respektohen” zëvendësohet me termin “vërehen (*ang. observed*)”.

Komenti 6, Burim Begu, LKIA: *“Rrugët e taksisë (rrugët e taksimit). Aeroplani gjatë levzijes në tokë I themi po takson.*

Mirepo si frazeologji, duhet të jetë Taksirruga, për shkak të komunikimit në radio, si fjale është më e shkurte (qeillimi I frazeologjive) dhe ky term Taksirruga është që njihet dhe përdoret nga Kulla dhe Vozitesit.”

Përgjigja nga AAC: Komenti pranohet pjesërisht. Termi aktual “rrugët e taksisë” do të zëvendësohet me “rruga lidhëse (*ang. taxiway*)”, në përputhje me terminologjinë e përcaktuar në Shtojcën I të Rregullores (AAC) nr. 17/2017. Ky është termi standard që duhet të përdoret në aktet zyrtare.

Pavarësisht kësaj, përdorimi i terminologjisë së brendshme në komunikimin operativ (“taksirrugë”) mbetet i pranueshëm, për sa kohë është i qartë dhe i kuptueshëm për të gjitha palët.

Sugjerimi do të merret parasysh gjatë rishikimit të ardhshëm të Rregullores 17/2017, sa i përket unifikimit të terminologjisë.

“...Lirojeni pistën dhe vëzhgoni kullën për sinjal drite...”

Komenti 7, Burim Begu, LKIA: *“Kjo bjen në kundërshtim me pikën d). Pasi që dritat e pistes dhe taksirruges përdoren nëse sinjalet e pistoletes me drite nuk vërehen.”*

Përgjigja nga AAC: Komenti nuk pranohet. Pikat (c) dhe (d) nuk janë në kundërshtim me njëra-tjetrën; ato përshkruajnë dy nivele të ndryshme sinjalizimi, që përdoren në varësi të situatës.

- Pika (c) përcakton sinjalet standarde të pistoletës me dritë, të cilat përdoren në rrethana normale kur ato mund të vërehen.
- Pika (d) aktivizohet vetëm në kushte emergjente ose kur sinjalet e pikës (c) nuk vërehen, duke lejuar përdorimin e dritave të pistës ose rrugës lidhëse (*taxiway*) si mjet alternativ për të dhënë urdhrin për lirim të sipërfaqes.

Pra, pika (d) nuk bie në kundërshtim me pikën (c); ajo e plotëson atë duke përcaktuar veprimin rezervë në rast se sinjalizimi primar nuk funksionon ose nuk shihet.

III. PËRFUNDIM

Bazuar në komentet e pranuar dhe trajtuara gjatë procesit të konsultimit publik, Autoriteti i Aviacionit Civil i ka kryer përditësimet përkatëse në Rregulloren (AAC) Nr. XX/2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 17/2017 në lidhje me përdorimin e sinjaleve në rast të dështimit të komunikimit në radio, duke reflektuar saktësimet e nevojshme terminologjike dhe procedurale. Të gjitha komentet tjera janë shqyrtuar dhe adresuar sipas sqarimeve të dhëna më sipër.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti i Aerodromeve
Autoriteti i Aviacionit Civil